



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublans), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2024/0023**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga; Isa Hasani-Kryetar, Vedat Poterqoi-Anëtar dhe Vjosa Gradinaj-Mexhuani- Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së OE "Tali" SH.P.K, kundër Vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja dimërore e Rrugëve në Gjilan” me numër të prokurimit 651-23-10479-2-1-1, të Komunës së Gjilanit në cilësi të autoritetit kontraktues (AK) më datën 24/01/2024, mori këtë:

## **Vendim**

1. Refuzohet, si e pabazuar ankesa e "Tali" SH.P.K me nr. 2024/0023, e datës 08/01/2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja dimërore e Rrugëve në Gjilan”, me numër të prokurimit 651-23-10479-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komunës së Gjilanit.
2. Vërtetohet “Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues” i publikuar më datën 22. 12. 2023, i Autoritetit Kontraktues, Komuna e Gjilanit, lidhur me aktivitetin e prokurimit me numër: 651-23-10479-2-1-1.
3. Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## **Arsyetim**

*- Faktet dhe rrethanat procedurale -*

Me 09.10.2023 Komuna e Gjilanit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Mirëmbajtja dimërore e Rrugëve në Gjilan” me numër të prokurimit 651-23-10479-2-1-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, negociuar, kufizuar, lloji i kontratës: punë, furnizim, shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 390,000.00 € sipas numrit: 93000000-8.

Komuna e Gjilanit me datën 22. 12. 2023 ka publikuar njoftimin për dhënie të kontratës operatorit ekonomik “El Bau”.

Me datë 27.12.2023, OE “Tali SH.P.K”, ka parashtruar ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK Komuna Gjilan. Me datë 29.12.2023 AK ka paraqitur Vendimin për refuzimin e Kërkesës për rishqyrtim.

Me datën: 08.01.2024, OE “Tali SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2024/0023, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Mirëmbajtja dimërore e Rrugëve ne Gjilan” me nr. të prokurimit: "651-23-10479-2-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Gjilan.

*-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-*

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

*Vendimi i Autoriteti kontraktues-Komuna e Gjilanit i dates 29.12.2023, lidhur me Kërkesen për Rishqyrtim të Operatorit ekonomik ankues “Tali SH.P.K.”, si në vijim;*

Lidhur me pretendimet ankimore si objekt shqyrtimi i kësaj kërkesë, duke u bazuar shkresat dhe dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, legjislacionin sekondar - Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik si dhe në pajtim me të gjitha dispozitat përkatëse të ligjeve tjera të zbatueshme për çështjet si në rastin konkret, AK - Komuna e Gjilanit ka vlerësuar si në vijim: 1. Pretendimet kryesore ankimore që konsistojnë me pohimin se nga ana e AK-së janë shkelur dispozitat për promovimin e transparencës sipas nenit 10 dhe 11 të LPP-së si dhe 7 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, janë të pabazuara sepse e vërteta është se AK ju ka ofruar qasjen në dokumentet e dosjes së OE të rekomanduar për dhënien e kontratës që konsiderohen të qasshme (publike) për palët e interesit në kuptim të nenit 10 paragrafi 3 dhe 5 të LPP-së dhe nga ana tjetër ju ka kufizuar qasjen në dokumentacionin e klasifikuar si sekret afarist lidhur me dokumentet e përcaktuara sipas nenit 68 dhe 69 të LPP-së sipas Aneksit 3 të dosjes së tenderit të OE të cekur më lartë në përputhje me kufizimet ligjore sipas 11 paragrafi 3, 4 dhe 5 të LPP-së lidhur me nenin 7 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik ssi dhe në përputhje me rregullat e përgjithshme administrative sipas nenit 5 dhe 9 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. AK-ja i ka ofruar dhe mundësuar përfaqësuesit të juaj me autorizim qasjen e plotë në informatat dhe dokumentet e qasshme për palët e interesit ashtu siç garantohet me nenin 10 par.3 dhe 5 të LPP-së me përjashtim të dokumentacionit të klasifikuar si sekret afarist sipas kërkesës së OE të shpërblyer me kontratë në kuptim të nenit 11 të LPP-së dhe dispozitave tjera të cekura si më lartë. Konkretisht ju kemi ofruar qasjen në informatat dhe dokumentet e mëposhtme: çertifikatën e biznesit; listën e kontratave të realizuara (sepse kontratat janë publike në e-prokurimi) ku janë të përshkruara titulli kontratës, shuma e kontratës, data e fillimit dhe e përfundimit dhe përfituesin; çertifikatat për kryerjen e punëve, listën e mjeteve dhe pajisjeve teknike për realizimin e projektit sipas Aneksi 7 të DT ku janë përshkruar të dhënat relevante të këtyre pajisjeve, apo edhe ndonjë dokument tjetër që nuk kufizohet si sekret afarist sipas nenit 11 të LPP-së. Por ju nuk keni shprehur interesim t’i pranoni informatat dhe dokumentet e përshkruara si më lart, andaj e shfrytëzojmë këtë mundësi që të njëjtat t’iu bashkëngjisim me këtë vendim dhe t’ua dërgojmë në email adresën e juaj talishpk17@hotmail.com në mënyrë që mos të publikohen në e-prokurimi duke qenë se nuk ka palë tjera të interesuara për qasje.

Andaj, ashtu siç e vërtetoni edhe me pretendimet kyçe të kërkesës (shih fq 4 dhe fq 5) insistimi i juaj ka qenë që të ju ofrojmë qasje në informacionet dhe dëshmitë tjera të klasifikuara si sekret afarist që lidhen me pasqyrat ekonomike dhe financiare (raporte financiare të deklarimit (CD) në ATK) sipas nenit 68 të

LPP-së, informacionet në lidhje me mundësitë teknike dhe/ose profesionale (diplomat, kontratat e punës apo marrëveshjet me punëdhënësin, referencat dhe CV e stafit teknik dhe profesional, fatura, DUD-a, librezë, marrëveshje) sipas nenit 69 i LPP si dhe ofertën financiare e cila në këtë fazë të procesit konsiderohet si sekret afarist i OE në fjalë duke qenë se nuk kemi vendim obligativ për marrëveshje kontraktuale deri në vendimin e shqyrtimit dhe skadimit të afatit ligjor për ankimim në mënyrë që paramasa të jetë publike sipas pikës (d) dhe (e) të nenit 28 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Në këtë kuptim kërkesa e OE ankues që të ketë qasje të pakufizuar në të gjitha të dhënat e dosjes së OE “El-Bau” të shpërblyer përkohësisht me kontratë nuk ka pasur asnjë mbështetje ligjore sepse OE “El-Bau” me rastin e ofertimit ka plotësuar aneksin 3 të DT përmes të cilit ka kërkuar nga AK - Komuna e Gjilanit që informatat dhe dëshmitë sipas nenit 68 dhe 69 të këtij ligji të klasifikohen dhe mbesin si sekret afarist për të gjitha palët duke përjashtuar palët e përcaktuara të nenit 7.3 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Sipas kërkesës në fjalë OE “El-Bau” ka kërkuar mbrojtjen e konfidencialitetit komercial me arsyetimin se informacionet apo dokumentet në fjalë nuk kanë të bëjnë me dokumente publike, dhe se vënja e tyre në dispozicion për OE konkurrent apo palët tjera, si dhe zbulimi i qëllimshëm apo nga pakujdesia do të rezultonte me dëmtim material dhe jo material të interesave komerciale legjitime të afarizmit të tij.

Pra, kjo gjendje faktike vërteton se kërkesa e OE të shpërblyer me kontratë “El-Bau” Sh.p.k. përmes deklaratës të Aneksit 3 të DT që dëshmitë në lidhje me pasqyrat ekonomike dhe financiare sipas neni 68 dhe dëshmitë në lidhje me mundësitë teknike dhe/ose profesionale sipas neni 69 i LPP-s të klasifikohen dhe mbesin si sekret afarist për të gjitha palët me përjashtimet e nenit 7.3 të RRPP, i përmbushë në mënyrë kumulative të tri kushtet e paragrafit 3 të nenit 11 të LPP-së siç përcaktojnë se: që atë ta ketë dërguar një operator ekonomik në përputhje me kërkesën e përcaktuar nga autoriteti i tillë kontraktues sipas nenit 68 ose 69 të këtij ligji; që operatori përkatës ekonomik t’i ketë dërguar autoritetit kontraktues kërkesën me shkrim duke shprehur dëshirën e tij që autoriteti kontraktues t’i mbajë artikujt e tillë si sekret; dhe kërkesa e tillë me shkrim të përmbajë një deklaratë me shkrim (i) në të cilën vërtetohet se një element i tillë nuk është pronë publike, dhe se të dhënat mbrohen nga operatori ekonomik nga zbulimi i qëllimshëm ose nga pakujdesia, dhe (ii) me të cilin parashtrohen arsyet, që bindshëm demonstronjë, sipas gjykimit të arsyeshëm të autoritetit kontraktues, se qasja publike në elementin e tillë do të rezultonte në dëmtimin material të interesave legjitime komerciale të operatorit të tillë ekonomik”.

Në anën tjetër, duke qenë se nga pretendimet e sajua jeni munduar që ta ngatëroni dhe keqinterpretoni edhe dispozitën e nenit 41 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës të, ju sqarojmë se pikërisht kjo dispozitë kushtetuese që ka të bëjë me qasjen në dokumente publike në paragrafin 2 të këtij neni i përcakton përjashtime të informacioneve që janë të kufizuara me ligj për shkak të privatësisë dhe të sekreteve afariste.. Në këtë pikëpamje juridike kriteri për qëllime të mbrojtjes së konfidencialitetit komercial përcaktohet edhe me Ligjin Nr. 03/L-215 Për Qasje në dokumente Publike të cilit ju keni referuar. Konkretisht kjo çështje është e rregulluar me paragrafin 2.7 të nenit 17 të këtij ligji i cili përcakton se: “Kufizimi i të drejtës për qasje në dokumente publike ushtrohet në përputhje me parimin e proporcionalitetit sipas ligjit përkatës për Procedurën e përgjithshme administrative, në përputhje me këtë ligj dhe vetëm për qëllime të mbrojtjes së: konfidencialitetit komercial siç janë sekretet e biznesit, sekretet profesionale apo të kompanisë. Po ashtu kjo çështje është e sqaruar në mënyrë të qartë edhe në interpretimet (pyetje- përgjigje) e publikuara në ueb faqen e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik.

Pra kjo gjendje faktike dhe juridike e vërteton në mënyrë të qartë se dokumentet siç janë: diplomat, kontratat e punës apo marrëveshjet me punëdhënësin, referencat dhe CV e stafit teknik dhe profesional, fatura, DUD-a, librezë, marrëveshje, raporte financiare të deklarimit (CD) në ATK, hyjnë në kuadër të të dhënave personale të sekreteve afariste. Në kuadër të dhënave konfidenciale është çdo informatë siç janë: emri dhe mbiemri, numri personal i ID-së, të dhënat e pagës që përcaktohen në kontratë, të dhënat e shkollimit (diploma), deklaratat tatimore, identifikuesi i rrjetit (adresa IP), etj duke ju nënshtruar detyrimit ligjor të konfidencialitetit të rregulluar nga legjislacioni përkatës. Prandaj, duke u nisur nga krahasimi i

pretendimeve të juaja me gjendjen faktike dhe juridike/ligj ore shihet qartë se veprimet e OE ankues janë të qëllimshme për të krijuar një pasqyrim të gabuar të gjendjes faktike dhe juridike që nuk ekziston, rrjedhimisht që nuk përkon aspak me realitetin. Krejt kjo është një orvatje e qëllimshme që të krijohet përshtypja që diçka e paligjshme ka ndodhur në dëm të OE ankues pavarësisht se OE ankues është i vetëdijshëm/ose e kundërta se realiteti është krejt ndryshe. Por edhe sikurse hipotetikiisht “argumentet” e OE ankues të ishin të bazuara, të njëjtat nuk do të ndikonin në rezultatin përfundimtar të vendim-marrjes të këtij vendimi lidhur me Njoftim Vendimin e AK-së të datës 22.12.2023 sepse OE i shpërblyer me kontratë, i radhitur para OE ankues ka plotësuar kriteret kualifikuese dhe vlerësuese të tenderit të përgjegjshëm me ofertën me çmim me të ulët. Prandaj nisur nga të lartcekurat, AK konsideron se në këtë çështje ka vepruar në përputhje me të gjitha kërkesat e dispozitave ligjore për promovimin e transparencës sipas nenit 10 dhe 11 të LPP- së lidhur me nenin 7 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik si dhe në përputhje me rregullat e përgjithshme administrative sipas nenit 5 dhe 9 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

2.Pretendimi i ankimor sa i përket pohimeve për shkelje të nenit 7 të LPP-së është i pa bazuar sepse veprimet, vlerësimet dhe vendimet e AK-së gjatë procesit të këtij aktiviteti deri në përfundimin e tij janë të drejta, të ligjshme, transparente dhe jo diskriminuese në pajtim me të gjitha parimet bazike të LPP-së, veçanërisht duke pasur në konsideratë nenin, 6 dhe 7 të LPP-së duke mos krijuar asnjë favor apo disfavor në dëm apo dobi të njëjës apo palës tjetër. Kështu që pretendimet e ngritura nga ana e OE ankues nuk janë të argumentuara me asnjë fakt apo provë konkrete në pikëpamje faktike dhe ligjore siç përcaktohet edhe në pikën (f) dhe (h) të paragrafit 3 të nenit 60 të Rregullores Nr. 001/2023 për Prokurimin Publik. Kjo sepse OE ankues është orvatur që të krijojë pretekste duke sajuar fakte dhe situata të paqena që paraqesin dëshirën apo qëllimin e tij dhe jo gjendjen faktike dhe kërkesat ligjore të zbatueshme në këtë rast.

3.Pretendimet ankimore sa i përket pohimeve për shkelje të nenit 59 dhe nenit 69 të LPP- së janë të pabazuara sepse veprimet, vlerësimet dhe vendimet e AK-së lidhur me ofertat/tenderët e dorëzuar nga ana e OE konkurrues janë të drejta dhe të ligjshme në pajtim me të gjitha kriteret kualifikuese dhe kriterit për dhënien e kontratës të përcaktuar në dosjen e tenderit si dhe në pajtim të plotë me nenin 59 paragrafi 4 lidhur me nenet 68 dhe 69, nenin 60 paragrafi 1.1 të LPP-së duke e pasur në konsideratë nenin 1 dhe 6 të këtij ligji si dhe njëkohësisht sipas nenit 40 paragrafi 1, 6 dhe 13 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Kjo sepse tenderi/oferta e paraqitur nga ana e OE i shpërblyer me kontratë “El-Bau” Sh.p.k. është në përputhshmëri nga aspekti administrativ i kërkesave formale të dosjes së tenderit dhe në pajtueshmëri me të gjitha kushtet si dhe kriteret kualifikuese dhe specifikimet tjera përkatëse të dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë në pajtim të plotë me nenin 59 lidhur me nenin 68 dhe 69 të LPP-së si dhe nenin 40.6 të RRPP. Dhe duke qenë se i ka plotësuar kriteret kualifikuese dhe madje i ka tejkaluar dhe nga ana tjetër duke qenë se oferta e tij prej 38.06€ për njësi është më e lirë në krahasim me ofertën e OE ankues prej 39.99€ për njësi, atëherë rezultojnë se oferta/tenderi i tij e ka plotësuar kriterin për dhënien e kontratës sipas kriterëve për dhënien e kontratës të përcaktuara në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit dhe në pajtim me nenin 60 paragrafi 1.1. të LPP-së. Prandaj, duke qenë se oferta/tenderi i OE “El-Bau” Sh.p.k. i ka plotësuar kriteret kualifikuese dhe kriterin për dhënie të kontratës në relacion me ofertën/tenderin e OE ankues, AK me të drejtë ka marrë vendim brenda parashikimeve ligjore me të cilin e ka shpërblyer me dhënien e kontratës si tenderuesin e përgjegjshëm me çmim më të lirë prej 38.06€ për njësi. Përveç kësaj, AK-ja ka pasur në konsideratë qëllimin e prokurimit të këtij ligji që të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike ashtu siç parashihet në nenin 1 të LPP-së si dhe parimin e ekonomicitetit dhe efikasitetit që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP.

Për këto arsye, AK vjen në përfundim se pretendimet e paraqitura në arsyetimin e kërkesës për rishqyrtim nuk janë të bazuara me asnjë fakt apo provë relevante pasi që procesi i vlerësimit dhe ekzaminimit të tenderëve është zhvilluar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme, andaj si rrjedhojë vendimi për dhënien e kontratës OE “El-Bau” Sh.p.k. dhe Letra Standarde për tenderuesin e pasuksesshëm në relacion me OE ankues “Tali” Sh.p.k. është i bazuar dhe i ligjshëm. OE ankues në pretendimet e paraqitura në asnjë rast

nuk ka paraqitur asnjë fakt apo provë për të përshkruar rrethanat faktike për shkeljen e shkaktuar dhe mënyrën se si ajo ju është shkaktuar sipas pikën (f) dhe (h) të paragrafit 3 të nenit 60 të RRPP në relacion me të rekomanduarin për kontratë i cili është me çmim më të lirë i radhitur para ankuesit. Në këtë kuptim AK konsideron se pretendimet e OE ankues nuk kanë bazë argumentuese dhe provuese që aktiviteti të kthehet në rivlerësim sepse kthimi i një aktiviteti në rivlerësim pa bazë ligjore është në kundërshtim me parimet themelore të prokurimit publik (drejtësia/mos-diskriminimi, efikasiteti & efektiviteti, ekonomiciteti, konkurrenca) dhe me nenin 1 dhe 6 të LPP-së. Por e përbashkëta e të gjitha pretendimeve të OE ankues lidhet me pengim dhe me ankesa realizimi i këtij projekti pa pasur asnjë shkelje ligjore dhe asnjë dëm të pësuar për OE ankues pavarësisht se i njëjti është i vetëdijshëm për rëndësinë e tij në relacion me jetën e njerëzve dhe sigurinë publike duke qenë se jemi në sezon dimërore.

4.Pretendimi për shkelje të nenit 97.1 të RRPPP është i pabazuar sepse të gjitha veprimet dhe vendimet e AK-së siç janë përshkruar më lartë janë në pajtim me kompetencat, përgjegjësitë dhe diskrecionin ligjor të AK-së të ushtruar në përputhje me të gjitha dispozitat përkatëse ligjore të LPP, RRPP dhe ligjeve tjera përkatëse në fuqi.

*Pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE "Tali SH.P.K." të parashtruar në OSHP, si në vijim:*

*Pretendimi i parë (I):* Sipas OE ankimor, ka te beje me: shkeljen e nenit 10 dhe 11 të Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 dhe Nenin 7 të Rregullores 001/2022, nen arsytimit se te Deklarata për Sekret Afarist nga ana e OE të rekomanduar për kontratë nuk e ka specifikuar se për çfarë demi jemi duke folur.

*Pretendimi i dytë (II):* OE "TALI SH.P.K." ka paraqitur ankese dhe te pretendimi 2, fokusi i ankimit është se OE i Rekomanduar për Kontrate nuk posedon apo plotëson kriterin e pajisjeve ashtu siç është kërkuar ne Aneksin nr. 7 -Pajisjet dhe Mekanizimi i Obligueshëm.

*Pretendimi i tretë (III):* OE "Tali SH.P.K." te pretendimi 3 deklaroi se AK Komuna Gjilan ka paraqitur kriteret te cilat kane tentuar ta eliminojnë konkurrencën ne mes operatoreve ekonomik duke futur kërkesa te pa nevojshme.

*Pretendimi i katërt (IV):* OE "Tali SH.P.K." ka paraqitur ankese dhe te pretendimi 4, fokusi i këtij pretendimi ishte se AK ka vepruar ne kundërshtim me nenin 7 të LPP-së 1. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

*Pretendimi i pestë (V):* OE "Tali SH.P.K." ka paraqitur ankese dhe te pretendimi 5, fokusi i këtij pretendimi ishte se AK ka vepruar ne kundërshtim me nenin 10 të LPP-së: Neni 10 Mjetet për promovimin e Transparencës paragrafi 3. Me kërkesën me shkrim nga cilado palë e interesit, autoriteti kontraktues i siguron qasje të arsyeshme palës që kërkon të ketë qasje në të dhënat e përshkruara në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni, përveç informatave sekrete afariste të cilat vërtetohen si të tilla nga një autoritet përkatës që kanë të bëjnë me çfarëdo aktiviteti të prokurimit që është mbyllur. Për qëllime të paragrafit 3. të këtij neni, aktiviteti i prokurimit konsiderohet i mbyllur (i) në datën e publikimit të njoftimit për dhënien e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit, (ii) në datën e dhënies së kontratës në rast të tenderëve sipas nenit 37 të këtij ligji, ose (iii) nëse aktiviteti i prokurimit formalisht është anuluar ose përndryshe është përfunduar para dhënies ose zgjedhjes së fituesit, atëherë në datën e njoftimit për anulim sipas paragrafit 2. të nenit 62 të këtij ligji ose në datën kur aktivitetet ishin përmbyllur. OE "TALI SH.P.K."- Prishtinë ka paraqitur ankese dhe te pretendimi 5, fokusi i këtij pretendimi ishte se AK ka vepruar ne kundërshtim me nenin 11 të LPP-së, konkretisht paragrafi 4. Autoriteti kontraktues që e ka klasifikuar një element të informatës si informatë sekrete afariste sipas paragrafit 3. të këtij neni, do të përgatit versionin e "pastruar" të çdo dokumenti, nëse elementi i tillë gjendet në dokumentin në të cilin po ashtu gjendet informacioni që nuk konsiderohet të jetë sekret. Versioni i tillë i pastruar duhet të përfshihet në materialin në të cilin ka qasje publiku dhe palët

e interesuara sipas nenit paragrafit 3. të nenit 10 të këtij ligji. Autoriteti kontraktues do të bashkëngjisë në ballinë të versionit të tillë të pastruar një njoftim që thotë se (i) autoriteti kontraktues i ka klasifikuar disa elemente të caktuara të informatës në dokumentin origjinal si informata sekrete afariste, me kërkesën e operatorit përkatës ekonomik, dhe (ii) versioni i pastruar i bashkangjitur është përgatitur nga autoriteti kontraktues dhe është një kopje e saktë e origjinalit pas heqjes ose fshirjes së informatave të tilla sekrete afariste.

*Pretendimi i gjashtë (VI):* OE “Tali SH.P.K.” ka paraqitur ankese dhe te pretendimi 6, fokus i këtij pretendimi ishte se AK ka shkelur ligjin gjate ekzaminimit, krahasimit dhe vlerësimit te tenderit dhe duke kërkuar dëshmi nga Operoret Ekonomik për te treguar se ata i plotësojnë minimalisht kriteret e përcaktuara nga AK.

*Pretendimi i shtatë (VII):* OE “Tali SH.P.K.” ka paraqitur ankese dhe te pretendimi 7, thekson se AK Komuna Gjilan e ka shkelur nenin 7 të RROUPP-së dhe fokus kryesor ne këtë shkelje e ka se vetëm informatat e klasifikuara, nga OE-te dhe te pranuar nga AK si sekret afarist do te mbesin sekret.

*Pretendimi i tetë (VIII):* OE “Tali SH.P.K.” ka paraqitur ankese dhe te pretendimi 8, duke theksuar se AK Komuna Gjilan nuk e ka respektuar Ligjin për Qasje në Dokumente Publike.

*- Administrimi dhe vlerësimi i provave –*

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrësat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 09/01/2024 ka autorizuar eksperten shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 23/24, ndërsa me datë 17/01/2024 është dorëzuar raporti i ekspertës shqyrtuese me nr. 2024/0023 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet dhe të gjeturat në këtë ekspertizë, eksperti shqyrtues profesional i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e Tali SHPK të refuzohet si e pabazuar, dhe të mbetet në fuqi Vendimi i Autoritetit Kontraktues i datës 22.12.2023 i publikuar në platformën elektronike e-prokurimi.

*Lidhur me pretendimet e OE “Tali” SHPK eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/0023 ka vlerësuar si në vijim:*

*Konstatimi i parë (I):* OE i rekomanduar për kontratë nga AK-Komuna Gjilan, sipas lidhjes se ofertës: Emri i kompanisë dhe adresa e plote: EL-BAU SH.P.K., LIMON STANECI P.N ka paraqitur te Dokumentacioni Anekset, Deklaratën mbi Konfidencialitet (Aneksi 3) sipas Dosjes se Tenderit, dhe se AK e ka për detyre te ruaj konfidencialitetin e paraqitur dhe kërkuar nga ana e kompanisë Ofertuese, kjo gjene zbatim ne atë: duke u mbështetur ne nenin 11 të Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092. Konkretisht pika 3. Autoriteti kontraktues mund t’i klasifikojë informatat e tjera si informatë sekrete afariste vetëm nëse informata përkatëse i përmbushë këto tri kriteret: nen paragrafi 3.1 që atë ta ketë dërguar një operator ekonomik në përputhje me kërkesën e përcaktuar nga autoriteti i tillë kontraktues sipas nenit 68 ose 69 të këtij ligji. Duke u bazuar në Vendimin e Refuzimit të Kërkesës për Rishqyrtim, AK ju është përgjigjur secilit pretendim veç e veç ku të pretendimi i juaj i parë ka theksuar se ju ka ofruar qasje ne dokumentacionet qe lejohen qe kompanitë konkurruese t’i kenë, dhe se ju keni refuzuar qasjen ne këto dokumente. Lidhur me vendimin e OE TALI SHPK nuk ka atakuar fare, sqarimet e paraqitura ne vendimin e AK pasi qe AK ju ka ofruar qasjes ne dokumentacionin qe lejohet te kenë qasjes palët e interesit. Fjale finale nga Eksperti: Pretendimi i OE TALI SHPK është i pabazuar, pasi qe qasje ne dokumente është e rregulluar me Ligj dhe se dokumentet klasifikohen përmes nenit 11 të LPP-së.

*Konstatimi i dytë (II):* OE i rekomanduar për kontratë ne Filen (tek lidhja e ofertës), numër 10, Makinaria ka paraqitur një dokumentacion lidhur me mekanizimin e kërkuara nga ana e AK ku ka nënshkruar dhe vulosur ashtu siç është kërkuar në Aneksin 7 dhe ka bashkangjitur një liste te pajisjeve me 52 pajisje te ndryshme dhe disa marrëveshje për marrje me qira te makinerisë nga kompani tjera dhe si i tille Eksperti shqyrtues pretendon se OE e ka plotësuar këtë kriter te përcaktuar nga ana e Autoritetit Kontraktues. Ky FILE ka një kapacitet te dokumentacioneve prej 41 faqeve te cilat kane librezat e makinerisë, marrëveshjet për marrje me qira te vulosura dhe te noterizuara. Fjale finale nga Eksperti: Pretendimi i OE TALI SHPK është i pabazuar, pasi qe qasje ne dokumente është e rregulluar me Ligj dhe se dokumentet klasifikohen përmes nenit 11 të LPP-së dhe se ky dokumentacion mbulohet sipas nenit 11, qe ndërlidhet me nenin 68 dhe 69 të LPP-së.

*Konstatimi i tretë (III):* Eksperti profesional nuk mund te paraqes përkufizim ligjor lidhur me këtë pretendim (pasi qe nuk është nen mandatin e tij) gjykimi i aspekteve për te cilat ka kaluar afati, lidhur me këtë pretendim ju si OE do te mund t'a atakonit ne OSHP, Formularin e Dosjes se Tenderit edhe para hapjes se ofertave pasi qe një gjë e tille është e rregulluar edhe me LPP dhe lejohet. Andaj konstatimi është se ky pretendim nuk trajtohet.

*Konstatimi i katërt (IV):* Eksperti profesional thekson se nga ato se çfarë u panë me lartë AK i ka dhënë dokumentacionin e lejuar me LPP, OE Tali SHPK dhe se mos jepja e dokumentacionet te cilat mbulohen përmes LPP-se, konkretisht nenit 11 nuk do te thotë se AK ka trajtuar ne mënyrë te pabarabartë dhe diskriminuese OE Tali SHPK. Pretendimi është i pabazuar.

*Konstatimi i pestë (V):* Eksperti profesional thekson se nga ato se çfarë u panë me lartë AK i ka dhënë dokumentacionin e lejuar me LPP po ashtu edhe neni 10 i LPP-së e thekson qartë: 3. Me kërkesën me shkrim nga cilado palë e interesit, autoriteti kontraktues i siguron qasje të arsyeshme palës. Pra, AK nuk ka mundur t'i lejoje qasje OE me dokumentacionin i cili gjene zbatim ne atë se çfarë llogaritet sekret afarist. Pretendimi është i pabazuar. Ashtu siç paraqitur edhe me lartë, AK ne vendimin e datës 29.12.2023 ka theksuar qe OE TALI SHPK ka refuzuar marrjen e dokumentacionit te klasifikuar, ku ka theksuar se AK i ka lejuar qasje te plote për dokumentacionin e lejuar personit qe ju si kompani e keni autorizuar duke theksuar ne veçanti te gjitha dokumentacionet qe lejohen ku ju si OE nuk keni shpallur interes t'i pranoni dokumentacionin dhe si te tille AK i ka dorëzuar edhe ne [talishpk17@hotmail.com](mailto:talishpk17@hotmail.com). Si i tille pretendimi i juaj është i pabazuar.

*Konstatimi i gjashtë (VI):* Bazuar në pretendimet e paraqitura nga ana e juaj (e te gjitha janë duke u mbështetur ne mos qasjen ne dokumente zyrtare) ani pse AK pretendon se i ka dërguar te ju, ju si Operator Ekonomik nuk keni paraqitur asnjë pretendim konkret se OE i rekomanduar nuk e plotëson kriterin 1 apo 2, apo te ngjashëm, për te vetmin pretendim qe keni dërguar keni dërguar për listën e makinerisë dhe qe keni pranuar detajet e paraqitura me lartë si i tille pretendimi i juaj është i pabazuar dhe se nga pretendimi 1 e deri në 6 (duke mos e përfshirë pretendimin 2) janë pretendime identike te cilat kanë marrë përgjigje detale nga ana e AK dhe ana e ekspertit profesional.

*Konstatimi i shtatë (VII):* Bazuar në atë se çfarë u tha me lartë, pas analizimit të legjislacionit, theksohet se kjo Rregullore tani me është e shfuqizuar, si i tille precizimi mbi një rregullore te shfuqizuar llogaritet si e pabazuar pasi qe vet rregullorja nuk ka mandat për një procedurë të nisur pas datës 01.11.2022. Aspekti i nenit 97.1 pika C, Mos lejimi dhe/ose neglizhimi i qasjes në dokumenteve zyrtare sipas kërkesës me shkrim të parashtruar nga pala e interesit kur një qasje e tillë e kërkuar është në përputhje me nenin 10 dhe 11 të Ligjit të Prokurimit Publik, duke u bazuar në atë se AK i ka dhënë qasje kompanisë TALI, edhe ky pretendim është i pabazuar.

*Konstatimi i tetë (VIII):* Pretendimi i paraqitur nga ana e OE TALI SHPK është i PABAZUAR pasi që Ligji për Qasje në Dokumente Publike nuk e mbulon aspektin e Ligjit të Prokurimit Publik dhe Rregulloreve tjera në fuqi, ky Ligj thekson se palët e interesuara mund te marrin qasje në një Autoritet dhe se Autoriteti duhet t'i paraqes këto dokumente deri ne afat 7 ditë pas paraqitjes se Kërkesës (në këtë

formë OE ju pamundësohet të paraqes Kërkesë për Rishqyrtim e cila ka afat 5 ditë pasi të paraqitet Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues). Ligji për Qasje në Dokumente Publike, askund nuk e precizon se nëse një Dispozitë e një Ligji tjetër e parasheh ndalimin e publikimit të disa dokumenteve (edhe këto duhet të jepen për palët tjera), andaj thirrja në këtë Ligj është e gabuar nga ana e OE-së.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaroi se pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE nuk është deklaruar me raportin e ekspertit shqyrtues.

*- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –*

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik nr.83/20, e datës, 03.03.2020, e cila gjendet e publikuar në Webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcaktoi kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtrësit e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli shqyrtues me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, ka administruar si prova: Raportin e Ekspertit Shqyrtues, ankesa e Operatorit Ekonomik, Njoftimin për Kontratë, Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, për të shpërblyer me kontrate OE për aktivitetin e prokurimit, Raportin e Vlerësimit të Komisionit Vlerësues të AK, Vendimin e Autoritetit Kontraktues lidhur me Kërkesën për rishqyrtim.

Paneli shqyrtues pas vlerësimit dhe administrimit të të gjitha provave sipas ankesës të dorëzuar me numër protokoll Nr. 23/24 sqaron se konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit dhe janë të bazuara edhe në dispozitat përkatëse të LPP dhe RRPP. Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Tali” SHPK i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit shqyrtues. Me këtë rast Paneli



Shqyrtues ka marrë në konsideratë edhe përgjigjet e palëve lidhur me raportin e ekspertit dhe përgjigjen e dhënë nga Autoriteti kontraktues. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë të pabazuara.

Paneli Shqyrtues bazuar në të gjeturat e ekspertit shqyrtues, konstaton se ankuesi nuk ka arritur të dëshmojë me prova konkrete se ka pasur shkelje ligjore nga ana e Autoritetit Kontraktues gjatë zhvillimit të aktivitetit të prokurimit në fjalë. Andaj Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se Autoriteti kontraktues ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore, nenin 59 të LPP dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja dimërore e Rrugëve në Gjilan”, me numër të prokurimit 651-23-10479-2-1-1., Rrjedhimisht Paneli shqyrtues ka vendosur për të refuzuar ankesën e Operatorit Ekonomik “Tali” Sh.P.K, dhe ka Vërtetuar Vendimin e AK -B58 të publikuar me datën, 22. 12. 2023, të Autoritetit Kontraktues, Komuna e Gjilanit lidhur me aktivitetin e prokurimit.

Mbi bazën e sqarimeve të ekspertës shqyrtuese paneli vlerëson se duke u bazuar në rrjedhën e këtij aktiviteti të prokurimit të prezantuar në dokumentacionin e procedurës së prokurimit, Autoriteti Kontraktues e ka bërë Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve, në pajtim me nenin 59 par. 4 të LPP-së, sepse nga OE i rekomanduar për kontratë janë dorëzuar të gjitha dëshmitë në pajtueshmëri me kërkesën e kërkuar në Dosjen e Tenderit. Prandaj, në bazë të analizës së dokumentacionit të prezantuar, pretendimet ankimore të Operatorit ekonomik “Tali” shpk, kundrejt Operatorit ekonomik të rekomanduar “El Bau”, janë të paqëndrueshme, pasi që Autoriteti Kontraktues, e ka shpallur fitues OE-në, i cili ka dorëzuar tenderin e përgjegjshëm administrativisht dhe me çmimin më të ulët, OE ankues “Tali” shpk, ka ofertuar me çmim prej, 39.99 euro, derisa OE i rekomanduar “El Bau”, ka ofertuar me çmim prej, 38.06 euro.

Pa nevojë për analiza tjera të pretendimeve ankimore dhe provave tjera, OSHP nisët gjithnjë nga fakti se çdo AK (në çdo nivel) gëzon pavarësinë e plotë në ushtrim e kompetencave dhe caktimin e nevojave në harmoni me kapacitetet buxhetore mirëpo AK duhet të kujdeset ex-officio edhe për parimet bazë të LPP-së dhe gjatë hartimit të kriterëve të dosjes së tenderit të mos hartojë specifikime teknike që bien ndesh me dispozitat e LPP-së. Paneli gjithnjë nisët nga rregullat, zgjidhjet dhe parimet e LPP sipas të cilit secili AK ushtron pavarësinë e tij/sajë në kuptim të nenit 8 dhe 9 lidhur me planifikimin e prokurimit dhe parashikimin e nevojave, mirëpo kriteret e parapara gjithnjë duhet ta garantojnë barazinë e OE të cilët parashihen si të tillë edhe me DT e cila në kuptim të nenit 27, lidhur me nenin 28, përbën dokumentin kyç të prokurimit publik. Në asnjë rast, autoriteti kontraktues nuk duhet që të përfshijë, saktësojë ose përdorë kriteret të përzgjedhjes që bazohen në konsiderata të tjera përveç atyre të lejuara nga dispozitat e neneve 65-70 të këtij ligji.

Paneli shqyrtues bazuar në faktin e refuzimit të ankese të OE, vendosi të konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP, ndërsa mjetet të kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Panelit Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, dhe nenin 105 nenin të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Isa Hasani**

*Hasani*

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimin të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL- GJILAN**
- **OE - TALI SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: